



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr _____

Dt: 04.11.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 8,9,10 dhe 14.a të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Komunale, Përfundimit 01 nr. 06-75711-18/6 i dt. 23.10.2015 më të cilin është aprovuar kërkesa e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport për mbulimin e shpenzimeve të Klubit Futbollistik “Luftëtari” me dt. 04.11.2015 e miraton këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Klubit Futbollistik “Luftëtari” nga Gjakova nr. 10-400-75649 e dt: 22.10.2015, për mbulimin e shpenzimeve të pjesës së mbetur të kampionatit, duke e mbështetur këtë kërkesë me subvencione komunale të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në vlerë prej 1,000.00€.
2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procedurën e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 1,000.00€, nga mjetet e fondit të subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe bartjen e tyre në konton e Klubit Futbollistik “Luftëtari” nga Gjakova nr.1505001004000560 RFB.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë.

CO: - Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Klubit të Futbollit “Luftëtarit” Brekoc-Gjakovë
- Arkivit

Kryetarja e Komunës,

Znj. Mimoza Kusari- Lila